



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2022:036950

Datë: 05.10.2023

Numri i dokumentit: 04755674

P.nr.414/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTIË – DEGA FUSHË KOSOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, sipas Gjyqtares Laura Hoti Statovci, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Albrim Kastrati, në lëndën penale të akuzuarit M. P. nga O., i akuzuar për veprën penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.6256/2021 të datë 23.02.2022, në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 26.09.2023, në praninë e Prokurorit të Shtetit Lulzim Aliu dhe të akuzuarit M. P., me datë 29.09.2023 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 05.10.2023 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

M. P., e biri i A. dhe nëna F., e gjinisë K., i lindur me ..., në Gj., me vendbanim në Rr. “V. F.” nr..., O., me numër personal ..., të dhëna këto të vërtetuara nga dokumenti i letërnjoftimit të lëshuar nga MPB, student në fakultetin e DIF, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 31.10.2021, rreth orës 11:08, në Obiliq, i pandehuri pa autorizim ka poseduar substancë narkotike të llojit Marihuanë, me peshë prej, 0.35 gram, në atë mënyrë që pasi zyrtaret policor kanë ndaluar veturën V., me targa ..., të cilën e voziste tani dëshmitari R. H. në rrugën “H. P.” në të cilën si pasagjer ishte edhe i pandehuri dhe gjatë kontrollit, të pandehurit i është gjetur dhe me pas edhe sekuestruar substanca e tillë narkotike.

- Me këtë ka kryer veprën penale *Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge* nga neni 269 par 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 44, 69, 70, 71, 72 dhe 269 të KPRK-së dhe neneve 358, 359, 360 dhe 364 të KPPRK-së, të akuzuarin:

E GJYKON

- I. Me dënim me gjobë në shumën prej njëqind (100) Euro dhe dënim me burgim në kohëzgjatje një (1) muaji i cilin dënim me pëlqimin e të pandehurit është zëvendësuar ne dënim me gjobë në shumën prej njëqind (100) Euro, ashtu që dënimi me gjobë është dyqind (200) Euro.
- II. Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë në shumë si më lart, gjykata do ti zëvendësoj të pandehurit dënimin me gjobë, në dënim me burg duke llogaritur 1 (një) ditë me 20 (njëzetë) euro të gjobës.
- III. Në bazë të nenit 269 par.1 të KPPRK-së konfiskohet substanca narkotike e llojit Marihuanë, me peshë të përgjithshme prej 0.35 gram
- IV. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, URDHËROHET asgjësimi i substancës së cekur në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, nga Policia e Kosovës në bashkëpunim me Prokurorinë.
- V. Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguaj shumën prej 20 (njëzet) në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shumën prej 20 (njëzet) euro në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP.II.nr.6256/2021 të datë 23.02.2022, ndaj të akuzuarit M. P. për shkak të dyshimit të bazuar mire se ka kryer veprën penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Gjykata, në këtë çështje penale juridike ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 26.09.2023, në prani të Prokurorit të Shtetit, Lulzim Aliu dhe të akuzuarit M. P., ku i akuzuari pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, e ka pranuar fajësinë për veprën penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 1 të KPRK-së, deklaroi se e ndjen vetën fajtor, shpreh keqardhje për këtë veprim dhe se i premtonte gjykatës se nuk do të përsërit veprimin e njëjtë. Po ashtu i ka deklaruar Gjykatës, se ka qenë përdorues i narkotikëve tani nuk është dhe i prezanton Gjykatës testin për përdorim të narkotikëve.

Pas deklarimit të akuzuarit, mendimit të prokurorit se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, pasi që një pranim i tillë bëhet në mënyrë vullnetare dhe se është i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë si dhe ky pranim i fajësisë është në përputhje të plotë me provat dhe gjendjen faktike si në aktakuzë. Gjykata konstatoj se i akuzuari e pranon fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, i akuzuari është i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë për të cilat është njoftuar nga Gjykata, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 242 par. 2 të KPPRK-së janë përmbushur. Ashtu që gjykata aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 357 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së,

si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 242 par. 6 lidhur me par. 2 të KPPRK-së, atëherë ne këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të akuzuarit se e pranon fajësinë në kuptim të nenit 242 par. 6 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara si: Raporti fillestar i incidentit me numër 2021-AJ-0379, i datës 31.10.2021; Raporti i policit Sh. P. #..., i datës 31.10.2021; Procesverbali mbi marrjen në pyetje të dyshuarit i datës 31.10.2021 dhënë në Stacionin Policor në Obiliq; Procesverbali mbi marrjen në pyetje të dëshmitarit i datës 31.10.2021 dhënë në Stacionin Policor në Obiliq; Raporti i Njesisë së forenzikes i datës 31.10.2021; Vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve i datës 31.10.2021; Raport i ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë, i datës 22.12.2021 si foto dhe provat tjera që gjenden të bashkangjitura në lëndë, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, rrjedh se në veprimet e të akuzuarit M. P. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i akuzuari e ka kryer veprën me dashje, ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese ne kuptim të nenit 70 të KPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për të akuzuarin, gjykata ka vlerësuar faktin se i njëjti ka treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor duke pranuar fajësinë, duke u ndier i përgjegjshëm për veprimet e tij dhe duke shpreh keqardhje për veprën që e ka kryer. Të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese ne dobi të akuzuarit, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata ka gjetur faktin e rrezikshmërisë së lartë shoqërore të këtyre veprave penale.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjukata ne kuptim të nenit 43 të KPRK-se të akuzuarin e gjykoi si ne dispozitiv të këtij aktgjykimit, me të cilin do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Gjukata ka ardhur ne përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është ne përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjukata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit ne pengimin e të pandehurit ne kryerjen e veprave penale ne të ardhmen veçanërisht llojin e njëjte të veprës penale, por ai do të ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale ne përputhje me nenin 38 të KPPRK-se.

Duke u bazuar ne nenin 449 par. 2 pika 2.6 dhe 452 par.1 të KPPRK-se si dhe në bazë të nenit 36 par.3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit nr.08/L-109, Gjukata ka vendosur për shpenzimet e procedurës penale në shumën e përgjithshme prej 40 Euro.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 361 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA FUSHË KOSOVË,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL
P.nr.414/22 më datë 04.10.2023**

Gjyqtarja e vetme Gjykuese

Laura Hoti Statovci

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të të njëjtit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.